



Agjencia e Akreditimit e Kosovës  
Kosovo Accreditation Agency  
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 38 213-722  
Fax:: +381 38 213-990  
e-mail: [kaaoffice@gmail.com](mailto:kaaoffice@gmail.com)  
web: [www.masht-ks.net](http://www.masht-ks.net)

Nr. 235/09 dt. 11. 11. 2009

Për: Kolegjin Dardania

Mbështetur në LAL 2/2003 dhe Udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj: UA 14/2003 për Licencimin e institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë, UA 11/2004 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, UA 1/2009 për Akreditimin e Institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë dhe UA 12/2009 mbi kriteret dhe procedurat për akreditimin e Shkollave të larta profesionale dhe Shkollave të larta teknike në Kosovë), dëshiroj t'ju njoftoj se Këshilli Kombëtar i Cilësisë i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për akreditim dhe ka vendosur si në vijim:

### **Programet e akredituara**

Programet

- Administrim Biznesi (BA)
- Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA),
- Juridik i përgjithshëm (BA), me kusht të shkrirjes me programin e Kriminalistikës
- Administratë publike (BA)

Do të akreditohen për një vit në rastin e parë (1 Tetor 2009-30 Shtator 2010).

Kolegji "Dardania" obligohet që gjer me 30 nëntor 2009 të dorëzon në AAK Planin e përmirësimit të cilësisë në institucion (follow up) i përpiluar në bazë të rekomandimeve të Ekipit të ekspertëve që duhet të përmbushen gjer në vizitën e ardhshme.

### **Programet që nuk do të akreditohen**

- Menaxhment dhe Informatikë ( BA dhe MA).
- Administrim Biznesi (MA)
- Administratë Publike (MA)
- Psikologji (BA)
- Psikologji e biznesit (MA)
- Gjuhë dhe letërsi angleze (BA)

nuk akreditohet dhe nuk duhet të regjistroj studentë të rinj.

### **Akreditimi institucional**

Akreditimi si Kolegj

Më lejoni që t'ju uroj për marrjen e akreditimit dhe shpresoj që të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen sepse ne punojmë së bashku që të përkrahim përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit të lartë në Kosovë.

Prishtinë, 11.11.2009

Me respekt,  
Basri Muja, u.d. Drejtor

